



In medias res

MODALITETET DHE VARIACINET E MUNDSHME TË NDRYSHIMEVE NË ARSIM

Nga vitet e '90 të shekullit XX janë bërë avancime të mëdha në fushën e njohjes së ligjshmërive të ndryshimeve në arsim. Kontribut të madh në këtë fushë ka dhënë një plejadë e madhe e shkencëtarëve në mesin e të cilëve mund të veçohen Senge, Hargreavis, Stoll, Fink, Gudllad, Gardner, Fullan, Orstein, Hunkins etj. Të gjithë këta dhe shumë të tjerë kanë kontribuar që tani të ekzistojë një bazë shumë e mirë teorike e cila mund të përdoret për të bërë ndryshime të qëndrueshme dhe efektive në sistemin e arsimit. Këto ndryshime janë komplekse dhe të ndërlikuara sepse në to merr pjesë një numër i madh i subjekteve të ndryshme nga fushat e ndryshme të jetës. Baza e gjerë e njohjeve ka ndikuar që të themelohet një disiplinë e re shkencore që quhet: Teoria e ndryshimeve në arsim. Kjo teori bazohet në njohjet e shumë disiplinave tjera shkencore. Por në mesin e këtyre disiplinave dy disiplina janë kryesore:

- a) Edukologjia
- b) Pedagogjia konstruktiviste

Edukologjia, e cila ndryshe quhet edhe emërtohet si Pedagogji e përgjithshme ose Teori mbi edukatën, studion ligjet dhe ligjshmëritë e procesit të edukimit dhe aspektet e ndryshme të edukatës. Arritjet në fushën e kësaj shkence ndihmojnë që më mirë të kuptohen dhe të përcaktohen qëllimet morale të ndryshimeve dhe përfitime që duhet të gëzojnë qytetarët, fëmijët, nxënësit, dhe studentët nga ndryshimet në arsim.

Pedagogjia konstruktiviste paraqet shtyllën e dytë të ndryshimeve në arsim. Kjo disiplinë shkencore e Edukologjisë ndihmon të kuptuarit e koncepteve që lidhen me ndryshimet në arsim. Në kohën postmoderne e cila karakterizohet si kohë e pasigurisë, ndërlikueshmërisë dhe kaosit, pedagogjia konstruktiviste mundëson që brenda kaosit dhe ndërlikueshmërisë të krijohet koherenca dhe qartësia në ndryshime. Kjo shkencë mundëson që ndryshimet në arsim të ndodhin "në cepin e kaosit", ku krijohet një rend optimal për arritje të rezultateve maksimale, bazuar në kërkesat e Pedagogjisë maksimaliste apo të pritshmërive të larta.

Teoria e ndryshime ka identifikuar dy llojet të ndryshimeve:

- a) ndryshime evolucioniste
- b) ndryshimet revolucionare

Ndryshimet evolucioniste janë ato ndryshime që bëhen mbi rezultatet, përkatësisht mbi bazën e arritjeve ekzistuese. Kanë për qëllim përmirësimin e arritjeve, apo të gjendjes ekzistuese.

Ndryshimet revolucionare janë ato ndryshime të cilat janë plotësisht të reja dhe që nuk marrin për bazë gjendjen e ekzistuese. Ky lloj i ndryshimeve mund të ilustruhet me një shembull konkret: Kur jemi në një shtëpi e cila është vjetër dhe në të nuk mund të jetojmë, meremetimi dhe ri-rregullimi i saj është i pamundur andaj duhet ta rrënojmë dhe duhet të ndërtojmë një shtëpi krejtësisht të re. Në fushën e arsimit me ndryshim revolucionarë veprohet kur sistemi i arsimit është tërësisht në kolaps dhe nuk funksion më. Atëherë nevojiten ndryshime revolucionare. Ndryshimet revolucionare janë shumë të rralla, të vështira dhe shumë të kushtueshme. Zakonisht bëhen ndryshimet evolutive.

Ndryshimet mund të paraqiten në formën e këtyre modaliteteve: a) Inovimeve apo aktiviteteve inovative; b) Reformave arsimore dhe c) të transformimeve.

Shkroi: Halim Hyseni

(vazhdon)

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Gjatë muajit tetor ka vazhduar trajnimi i mësimdhënësve të Sh. F. “Isa Boletini” të fshatit Boletin të komunës së Zveçanit dhe Sh.F. “Kadri Bistrica” të fshatit Bistricë të komunës së Leposavicit. Në tetor janë mbajtur 3 seminare 2-ditore dhe është realizuar monitorimi i dytë për të gjithë mësimdhënësit pjesëmarrës. Trajnerët kanë raportuar se trajnimi është mbajtur sipas agjendës së paraparë dhe çdo gjë ka shkuar mirë. Në monitorimin e dytë është vërejtur një përmirësim i dukshëm i performancës së mësimdhënësve në zbatimin e teknikave dhe strategjive të MKLSH-së në klasë. Mësimdhënësit janë njoftuar se gjatë nëntorit do mbahet takimi i dytë gjysmëditor, seminari i fundit dhe certifikimi i pjesëmarrësve.

■ Më 4-5 tetor 2008 KEC ka filluar trajnimin e 7 grupeve në kuadër të programit të MKLSH. Kështu në Prishtinë ka filluar trajnimi i 2 grupeve, ndërsa në komunat e tjera si: Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Gjilan dhe Mitrovicë ka filluar trajnimi vetëm me nga një grup prej 32 mësimdhënësve. Përzgjedhja e kandidatëve është bërë në bashkëpunim me MASHT dhe DKA e qyteteve përkatëse. Edhe pse KEC bëri të gjitha përpjekjet për një fillim të mbarë, në shumë qytete pati problem në fillim me sistemin e kandidatëve dhe kjo për shkak të papërgjegjësisë së disa zyrtarëve të disa DKA-ve. Mirëpo gjatë ditës së dytë çdo gjë është stabilizuar dhe pjesëmarrësit pas seminarit të parë janë njoftuar se seminari i dytë do të mbahet më 8-9 nëntor 2008.

■ Më 25-26 tetor është mbajtur seminari i dytë i MKLSH në bashkëpunim me QD në Gjakovë. Është raportuar se çdo gjë ka shkuar sipas planifikimit.

Hap pas Hapi

■ Gjatë muajit tetor kanë vazhduar monitorimet nëpër institucione të ndryshme shkollore dhe parashkollore, të cilat punojnë me metodologjinë Hap pas Hapi.

Projekti për krijimin e mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla

■ Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) ka filluar zbatimin e projektit: Të krijojmë një mjedis të sigurt, jo të dhunshëm dhe human në shoqëri dhe në shkolla. Projekti financohet nga UNICEF. Projekti po zhvillohet sipas planit të paraparë. Gjatë muajit tetor është mbajtur punëtorja në Strugë, në të cilin kanë marrë pjesë 35 pjesëmarrës. Në Punëtori janë mbajtur gjashtë ekspozë nga Kosova dhe Rajoni, gjithashtu ka pasur punë në grupe dhe është përmbyllur me organizimin e një debati të hapur.



Pas përfundimit të punëtorisë është hartuar Raporti narrativ, i detajuar dhe me përfundime dhe rekomandime. Raporti do të botohet në gjuhën shqipe në web faqen: www.childrights-ks.org. Gjatë këtij muaji është mbajtur edhe një tryezë e rrumbullakët.

■ Është duke u zhvilluar një hulumtim i shpejtë për punën e Komiteteve shkollore. Faza e terrenit dhe e mbledhjes së të dhënave ka përfunduar, është duke u punuar intenzivisht në analizën e të dhënave dhe në përpilimin e raportit narrativ.

■ Po ashtu, në kuadër të këtij projekti është duke u bërë edhe rishikimi i manualit për komitetet shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Manuali është paraparë të publikohet në fund të muajit nëntor.

Projekti për përmirësimin e pjesëmarrjes në Arsim PPPA II

■ Gjatë muajit tetor është ndërmarrë monitorimi i realizimit të projekteve shkollore të ciklit të parë dhe të dytë. Projektet e ciklit të parë kanë përfunduar, derisa projektet e ciklit të dytë janë në fazën e implementimit. Nuk janë vërejtur vonesa në implementimin e deritashëm.

■ Në kuadër të komponentës së granteve komunale, më 9 tetor 2008 u mbajt takimi i Këshillit për Aprovimin e Granteve Shkollore. Në këtë takim u shqyrtuan planet zhvillimore komunale në arsim dhe projekt-propozimet për financim. Këto plane dhe projekte u aprovuan nga KAGSh. Janë katër komuna pjesëmarrëse në kuadër të komponentës së granteve komunale: Fushë Kosova, Obiliqi, Vushtrria dhe Prizreni. Këto komuna pas nënshkrimit të kontratave për grantin, do të vazhdojnë me implementimin e projekteve të tyre komunale.

Monitorimi i implementimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve RAE në arsim

■ Në kuadër të projektit “Monitorimi i Implementimit të Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve RAE në Arsim”, gjatë muajit tetor është punuar më shumë në planifikimin e disa aktiviteteve që do të mbahen gjatë muajit nëntor.

Mentorimi i projekteve për përkrahje të arsimimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

■ Gjatë këtij muaji janë kryer disa vizita në terren. Qëllimi i vizitave ka qenë për t’i parë nga afër ecurinë e aktiviteteve të qendrave, dhe në përgjithësi punën e qendrave, dhe për t’iu ofruar ndonjë ndihmë apo konsulentë. Këto vizita janë zhvilluar edhe në mjediset tjera ku zhvillohen aktivitetet e projekteve. Gjatë vizitave ka pasur edhe shumë takime me përfituesit e projekteve.



Është planifikuar që fillim të muajit nëntor të aranzhohet edhe një takim i përbashkët me tri qendrat, me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit në mes të këtyre tri qendrave.

KOSOVISION Contest

■ KOSOVISION CONTEST është projekt i Universitetit të Edukimit me seli në Cyrih të Zvicrës (Shkolla Pedagogjike në Cyrih), koordinohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) dhe e mbështetet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Për më shumë informata mund të vizitoni ueb-faqen zyrtare të projektit www.kosovision.org

■ Më 3 tetor 2008, KOSOVISION CONTEST filloi zyrtarisht implementimin. Hapja zyrtare, u organizua në Grand Hotel në Prishtinë nga ora 10.00-13.00 me afër 200 mysafirë të ftuar. Projekti është prezantuar nga Ardita Kabashi-Hima nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), ndërsa fjalë të rastit kanë mbajtur edhe ambasadori i Zvicrës në Kosovë Lukas Beglinger, Walter Bircher, drejtor i Universitetit të Edukimit nga Cyrihu, Agim Hyseni, zëvendësministër në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Programi artistik me performanca të ndryshme nga fëmijët, dhe interpretimin e këngëtares Vesa Luma dhe humoristit të njohur Fatmir Spahiu i dhanë një karakter festiv fillimit të këtij projekti.



■ Aktivitet i radhës në kuadër të këtij projekti ishte mbledhja me Drejtorët e Drejtorive Komunale të Arsimit dhe me drejtorët e shkollave ka përfunduar. Janë informuar të gjithë drejtorët dhe mësimitdhënësit e klasave të pesta për përmbajtjen e projektit dhe mënyrën e

punës në këtë projekt që kanë të bëjnë ata me nxënësit e tyre. Nga data 6 tetor, edhe ka filluar puna e fëmijëve në shkollat e tyre dhe kjo punë pritet të përfundojë në muajin nëntor kur edhe do të bëhen vlerësimet e punimeve të tyre.

AVSI-CESAL, Cilësia e arsimit në regjionin e Dukagjinit

■ Qendra për Arsim e Kosovës ka përfunduar përpilimin e pyetësorëve. Pyetësorët janë përgatitur për të gjithë mësimitdhënësit dhe drejtorët e shkollave fillore të Regjionit të Pejës dhe të Gjakovës. Gjatë muajit nëntor pyetësorët do të shpërndahen dhe pastaj do të plotësohen nga mësimitdhënësit dhe drejtorët, ndërsa përpunimi i rezultateve do të fillojë në muajin dhjetor.

Access Micro Scholarship Program

Ka filluar zbatimi i projektit English Access Micro Scholarship Program, të financuar nga Ambasada Amerikane.

Janë reviduar formularët për aplikim si dhe u janë shpërndarë nxënësve shqiptarë, serbë, boshnjakë dhe turq. Do të formohen dy grupe në Prishtinë dhe një në Prizren.

Gjatë nëntorit pritet të përfundojë procesi i përzgjedhjes, testimit dhe të fillohet me mbajtjen e orëve të gjuhës angleze. Mësimitdhënës do të jenë dy profesorë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Përgatiti: Petrit Tahiri